

VENDIM
Nr. 934, datë 26.12.2012

**PËR PËRCAKTIMIN E NUMRIT TË PUNONJËSVE ME KONTRATË TË PËRKOHSHME,
PËR VITIN 2013, NË NJËSITË E QEVERISJES QENDRORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 18 të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” dhe të nenit 11 të ligjit nr. 119/2012 “Për buxhetin e vitit 2013”, me propozimin e Ministrisë të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Numri i punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2013, në njësitë e qeverisjes qendrore, është 691 punonjës, sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Përjashtimisht, për punonjësit e përkohshëm për Agjencinë e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritetit të Zonave/Ndërtimeve Informale, për 5 punonjësit në sektorin e pagesave dhe dëmshpërblimeve në Ministrinë e Financave, si dhe për 6 punonjësit për procesin e fotokopjes të Ministrisë së Drejtësisë që lidhen me procesin e dëmshpërblimeve të ish-të përndjekurve politikë, nuk zbatohet pika 3 e vendimit nr. 1703, datë 24.12.2008 të Këshillit të Ministrave “Për vendosjen e standardeve të shërbimeve dhe aktiviteteve sezonale/të përkohshme për ministrinë dhe institucionet buxhetore”.

3. Përjashtimisht, për punonjësit e kontraktuar nga Instituti i Statistikave, të cilët do të merren me anketimet, miratimi i numrit të tyre, afatet kohore dhe të tjera specifikime bëhen sipas udhëzimit të përbashkët të INSTAT-it dhe Ministrisë së Financave.

4. Përjashtimisht, për instruktorët e kontraktuar për qendrat e formimit profesional nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, miratimi i numrit të tyre, afatet kohore dhe të tjera specifikime, bëhen sipas udhëzimit të përbashkët të Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe Ministrisë së Financave.

5. Përjashtimisht, për qendrat e transferimit të teknologjisë, në Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, për shkak të veçorisë së punës, pagesa e punonjësve të kontraktuar përlogaritet sipas volumit të punës së kryer.

6. Efektet financiare për zbatimin e këtij vendimi përballohen nga shpenzimet korente të miratuara në buxhetin përkatës të vitit 2013, të njësisë të qeverisjes qendrore. Përjashtimisht për ALUIZNI-n, QTTB-të, për punonjësit e Shtëpisë së Pushimit të Ministrisë së Brendshme dhe SHISH-it, efektet financiare përballohen vetëm nga të ardhurat e vetë institucionit. Efektet financiare për pozicionet e kontraktuara për periudhën kohore vjetore fillojnë më 1 janar 2013.

7. Ngarkohen ministrinë dhe institucionet buxhetore sipas lidhjes nr. 1 të përmendur në pikën 1, të depozitojnë pranë Ministrisë së Financave, detajimin e numrit të punonjësve në përputhje me kriteret e përcaktuara në vendimin nr. 1703, datë 24.12.2008 të Këshillit të Ministrave “Për vendosjen e standardeve të shërbimeve dhe aktiviteteve sezonale/të përkohshme për ministrinë dhe institucionet buxhetore”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 janar 2013.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Emri i Institucionit	Nr. Punonjesve	Emertesa	Koha mesatare ditore (deri ne...)	Periudhe kohore
Drejtoria e ALUIZNI-t Fier 1	11	Specialiste	8 ore/dite	vjetore
Drejtoria e ALUIZNI-t Fier 2	11	Ndihmes specialiste	8 ore/dite	vjetore
Drejtoria e ALUIZNI-t Lushnje	6	Ndihmes specialiste	8 ore/dite	vjetore
Drejtoria e ALUIZNI-t Kukes	1	Specialist	8 ore/dite	vjetore
Drejtoria e Aluiznit Diber	2	Specialist	8 ore/dite	vjetore
Drejtoria e Aluiznit Gjirokaster	2	Specialist	8 ore/dite	vjetore
Drejtoria e Aluiznit Berat	6	Specialist	8 ore/dite	vjetore
Ministria e Financave	19			
Aparati i Ministrise	1	punonjes protokolli	6 ore/dite	vjetore
Sektori i Pagesave te Demshperblimeve	4	Specialiste	8 ore / dite	vjetore
Sektori i Pagesave te Demshperblimeve	1	punonjes arkivi	8 ore / dite	vjetore
Drejtoria e Pergjithshme e Financimeve dhe e Kontraktimeve/dega e Thesarit Tirane	4	Roje	6 ore / dite	vjetore
DP e Financimeve dhe e Kontraktimeve	1	punonjes arkivi	6 ore/dite	vjetore
DP e Financimeve dhe e Kontraktimeve	1	Sanitar	6 ore / dite	vjetore
Deget e Thesarit	7	Sanitar	3 ore/dite	vjetore
Ministria e Shendetesise	15			
Spitali Psikiatrik Elbasan	2	Kaldaiste	8 ore/dite	janar-mars,nentor-dhjetor
DSHP Korce	2	Kaldaiste	8 ore/dite	janar-mars,nentor-dhjetor
DSHP Korce	2	Operatore	4 ore/dite	vjetore
DSHP Pogradec	2	Punetore mirmbajtje	4 ore/dite	vjetore
DSHP Permet	1	Punetore mirmbajtje	4 ore/dite	vjetore
DSHP Gjirokaster	1	Punetore mirmbajtje	4 ore/dite	vjetore
DSHP Tepelene	1	Punetore mirmbajtje	4 ore/dite	vjetore
ASHR Tirane	2	Punetore mirmbajtje	4 ore/dite	vjetore
ASHR Tirane	1	Operatore	4 ore/dite	vjetore
Aparati	1	Operatore	4 ore/dite	vjetore
Ministria e Drejtesise	7			
Aparati i Ministrise	6	Fotokopist	8 ore/dite	vjetore
Komiteti Shqiptar i Biresimeve	1	Sanitare	6 ore/dite	vjetore
Sherbimi Informativ Shtetor	18			
Sherbimi Shtetor Informativ (Shtepia Pushimit)	5	Kuzhinier	8 ore/dite	qershor-shtator
Sherbimi Shtetor Informativ (Shtepia Pushimit)	3	Banakier	8 ore/dite	qershor-shtator
Sherbimi Shtetor Informativ (Shtepia Pushimit)	10	Sanitare	8 ore/dite	qershor-shtator
Agjensia e Prokurimit Publik	1	Sanitar	6 ore / dite	vjetore
Avokati Prokurimeve	1	Mirembajtes	4 ore/dite	vjetore
Autoriteti i Konkurrences	1		12 ore/jave	vjetore
Autoriteti i Konkurrences	1	Punonjes mirmbajtes	6 ore/dite	vjetore
Avokati Popullit	2		12 ore/jave	vjetore
Avokati Popullit	1	Punonjes pastrim	6 ore/dite	vjetore
Avokati Popullit	1	Teknik	6 ore/dite	vjetore
Prokuroria e Pergjithshme	3			
Prokuroria e Apelit te Krimeve te Renda	1	Sanitar	4 ore / dite	vjetore
Prokuroria Rrethit Permet	1	Sanitare	4 ore / dite	vjetore
Prokuroria Rrethit Durres	1	Sanitare	5 ore / dite	vjetore
Zyra e Administrimit te Buxhetit Gjyqesor	5			
Gjykata Rrethit Diber, Elbasan, Lezhe, Mat, Pogradec	5	Mirembajtes	4 ore / dite	vjetore
Ministria e Punes, Ceshtjeve dhe Shanseve te Barabarte	27			
Shtepia e te Moshuarve Tirane	1	Mjek	3 ore / dite	vjetore
Shtepia e te Moshuarve Tirane	1	Sanitar	4 ore/dite	vjetore
Shtepia e te Moshuarve Kavaje	1	Mjeke	3 ore/dite	vjetore
Shtepia e te Moshuarve Kavaje	1	Sanitare	4 ore/dite	vjetore
Shtepia e te Moshuarve Shkoder	1	Mjeke	3 ore/dite	vjetore
Shtepia e te Moshuarve Shkoder	1	Sanitare	4 ore/dite	vjetore
Shtepia e te Moshuarve Gjirokaster	1	Mjek	3 ore/dite	vjetore
Shtepia e te Moshuarve Gjirokaster	1	Sanitare	4 ore/dite	vjetore
Shtepia e te Moshuarve Fier	1	Mjeke	3 ore/dite	vjetore
Shtepia e Foshnjes Tirane	1	Mjeke	3 ore/dite	vjetore
Shtepia e Foshnjes Durres	1	Mjeke	3 ore/dite	vjetore
Shtepia e Foshnjes Shkoder	1	Mjeke	3 ore/dite	vjetore
Shtepia e Foshnjes Korce	1	Mjeke	3 ore/dite	vjetore
Shtepia e Foshnjes Vlore	1	Mjeke	3 ore/dite	vjetore

Emri i Institucionit	Nr. Punonjesve	Emertesa	Koha mesatare ditore (deri ne...)	Periudhe kohore
Qendra e Zhvillimit Tirane	1	Mjeke	3 ore/dite	vjetore
Qendra e Zhvillimit Tirane	1	Sanitare	4 ore/dite	vjetore
Qendra e Zhvillimit Durres	1	Mjeke	3 ore/dite	vjetore
Qendra e Zhvillimit Korce	1	Mjeke	3 ore/dite	vjetore
Qendra e Zhvillimit Shkoder	1	Mjeke	3 ore/dite	vjetore
Qendra e Zhvillimit Berat	1	Mjeke	3 ore/dite	vjetore
Qendra e Zhvillimit Vlore	1	Mjeke	3 ore/dite	vjetore
Shtepia e femijeve parashkollore Shkoder	1	Mjeke	3 ore/dite	vjetore
Shtepia e femijeve shkollore Tirane	1	Mjeke	3 ore/dite	vjetore
Shtepia e femijeve shkollore Tirane	1	Sanitare	4 ore/dite	vjetore
Shtepia e femijeve shkollore Shkoder	1	Mjeke	3 ore/dite	vjetore
Shtepia e femijeve shkollore Sarande	1	Mjeke	3 ore/dite	vjetore
Qendra Polivalente Polican	1	Mjeke	3 ore/dite	vjetore
Ministria e Arsimit dhe Shkences	41			
DAR ne rrethe	13	Sanitar	4 ore/dite	9 muaj
ZAR ne rrethe	25	Sanitar	3 ore/dite	9 muaj
Agjensia Kombetare e Provimeve	1	Sanitar	4 ore/dite	vjetore
Agjensia Kombetare Arsimit e Formimit Profesional	1	Sanitar	4 ore/dite	vjetore
Agjensia Akreditimit te Arsimit te Larte	1	Sanitar	4 ore/dite	vjetore
Ministria e Puneve te Jashtme	7			
Spektori i Legalizimeve	2	Preparator	6 ore / dite	vjetore
Spektori i Arkivit	3	Arkiviste	6 ore / dite	vjetore
Spektori i Sherbimeve	1	Shperndares poste	6 ore / dite	vjetore
Spektori i Sherbimeve	1	Lulishtar	6 ore / dite	vjetore
Ministria e Brendshme	110			
Shtepia Pushimit Durres	4	guzhiner	8 ore/dite	01.06.12-30.09.13
Shtepia Pushimit Durres	4	ndihmes guzhier	8 ore/dite	01.06.12-30.09.13
Shtepia Pushimit Durres	30	kamarier	8 ore/dite	01.06.12-30.09.13
Shtepia Pushimit Durres	9	punetor restoranti	8 ore/dite	01.06.12-30.09.13
Shtepia Pushimit Durres	1	teknik	8 ore/dite	01.06.12-30.09.13
Shtepia Pushimit Durres	6	receptionist	8 ore/dite	01.06.12-30.09.13
Shtepia Pushimit Durres	16	punetor gjelberimi	8 ore/dite	01.06.12-30.09.13
Shtepia Pushimit Durres	10	punetor guzhine	8 ore/dite	01.06.12-30.09.13
Shtepia Pushimit Durres	25	punetor hoteli	8 ore/dite	01.06.12-30.09.13
Shtepia Pushimit Durres	1	elektricit	8 ore/dite	01.06.12-30.09.13
Shtepia Pushimit Durres	1	hidraulik	8 ore/dite	01.06.12-30.09.13
Shtepia Pushimit Durres	3	lavanteri	8 ore/dite	01.06.12-30.09.13
Total punonjes me kontrate	691			